

Në bazë të nenit 13, paragrafi (1) të Ligjit të Përcaktimit të Çmimeve të Shërbimeve të Ujit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/16), nenit 7, paragrafi (1) të Rregullores së Mënyrës dhe të Procedurës së Përcaktimit të Tarifës së Shërbimit të Ujit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 63/17) dhe duke iu përgjigjur Kërkesës së Përcaktimit të Tarifës së Grumbullit dhe të Deponimit të Ujërave të Zeza Urbane me Propozim-Tarifë për periudhë të rregulluar 2021-2023 të NP "Komunalec" Kërçovë të regjistruar në arkivin e Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë Veriut nën PA1 nr.08-119/20 datë 12 qershor 2020, Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 23 korrik 2020, miratoi:

A K T V E N D I M

për përcaktimin e tarifës së grumbullimit dhe të deponimit të ujërave të zeza urbane të NP "Komunalec" Kërçovë për periudhën e rregulluar 2021-2023

1. NP "Komunalec" Kërçovë i përcaktohet tarifë mesatare për shërbimin e ujit grumbullim dhe deponim të ujërave të zeza urbane edhe atë:
 - për vitin 2021 në shumë prej 7,07 den/m³;
 - për vitin 2022 në shumë prej 13,39 den/m³;
 - për vitin 2023 në shumë prej 19,51 den/m³;
2. Përcaktohet qarku i shumës së tarifës:
 - qarku minimal dhe maksimal për vitin 2021, ka vlerë prej 9,78%;
 - qarku minimal dhe maksimal për vitin 2022, ka vlerë prej 47,81%;
 - qarku minimal dhe maksimal për vitin 2023, ka vlerë prej 61,96%;
3. Përcaktohet tarifa mesatare minimale dhe maksimale në pajtueshmëri me qarkun minimal dhe maksimal sipas pikës 2 të këtij aktvendimi:
 - për vitin 2021:
 - tarifa mesatare minimale 6,38 den/m³;
 - tarifa mesatare maksimale 7,76 den/m³;
 - për vitin 2022:
 - tarifa mesatare minimale 6,99 den/m³;
 - tarifa mesatare maksimale 19,79 den/m³;
 - për vitin 2023:
 - tarifa mesatare minimale 7,42 den/m³;
 - tarifa mesatare maksimale 31,60 den/m³;
4. Obligohet ofruesi i shërbimit të ujit sipas pikës 1 të këtij aktvendimi t'i plotësojë kushtet sipas Planit të Përshtatjes së Tarifave për Shërbimet e Ujit, në pajtueshmëri me të cilat përlogaritet qarku minimal dhe maksimal i shumës së tarifës për shërbimin e ujit.

5. Tarifa e përcaktuar për grumbullim dhe deponim të ujërave të zeza urbane vlen për periudhën e rregulluar 2021-2023.
6. Aktvendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të tij në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, publikohet në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të zbatohet nga data 1 janar 2021.

A r s y e t i m

NP “Komunalec” Kërçovë, në pajtueshmëri me Rregulloren e Mënyrës dhe të Procedurës së Përcaktimit të Tarifës për Shërbimin e Ujit dhe të Tarifës Rregullatore për Shërbimin e Ujit (në tekstin e mëtejshëm: Rregullore), Metodologjinë e Përcaktimit të Tarifave për Shërbimin e Ujit (në tekstin e mëtejshëm: Metodologjia) dhe Udhëzimin e Përgatitjes së Kërkesës për Përcaktimin e Tarifës për Shërbimin e Ujit, parashtresave dhe kriterëve për vlerësim, deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit) ka parashtruar Kërkesë të Përcaktimit të Tarifës së Grumbullimit dhe të Deponimit të Ujërave të Zeza Urbane për periudhën e rregulluar 2021-2023, të regjistruar në arkivin e Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit nën PA1 nr.08-119/20 datë 12 qershor 2020 (në tekstin e mëtejshëm: Kërkesë).

Bashkë me Kërkesën, në pajtueshmëri me Metodologjinë NP “Komunalec” Kërçovë ka lëvruar dokumentacionin në vijim:

1. Bashkëngjitje 1- formular i plotësuar BTVU;
2. Letër mbuluese me arsyetim;
3. Bashkëngjitje 2 – deklaratë për besueshmëri të Kërkesës dhe të dhënave;
4. Bashkëngjitje 3 – Plan të Përshtatjes së Tarifave për Shërbimet e Ujit me Propozim Tarifa për Shërbimet e Ujit;
5. Të dhëna dhe raporte nga Plani afarist, që janë të obligueshme për përcaktimin e tarifave për shërbimet e ujit;
6. Bashkëngjitje 4- listë e plotësuar e treguesve kryesorë për sukses dhe qëllime;
7. Aktvendim të Regjistrimit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me të gjitha ndryshimet dhe Statutin e ofruesit të shërbimit të ujit;
8. Raporte financiare dhe bruto balance për tre vitet e mëparshme, me të gjitha bashkëngjitjet në pajtueshmëri me rregullativat e vlefshme ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Të dhënat e lëvruara

NP “Komunalec” Kërçovë në Kërkesë i ka prezantuar të dhënat në vijim:

- Të dhënat për vitin themelor 2019:

Përshkrimi	2019
Shpenzime për materiale, energji, pjesë rezervë dhe inventar të imët	1.718.258
Shpenzime për mirëmbajtje aktuale, riparim dhe shërbime për mirëmbajtje të mjeteve elementare	196.872
Shpenzime për sigurim të mjeteve elementare	16.040
Bruto rroga	4.795.744
Shërbime të tjera	89.820
Shpenzime të mbetura dhe të jashtëzakonshme	202.594
Tatime, kontribute dhe shpenzime të tjera që nuk varen nga rezultati	36.550
Gjithsej shpenzime operative	7.055.877
Tarifa mesatare e përlogaritur që është realizuar	6,25

- Të dhëna për periudhën e rregulluar :

Përshkrimi	Nj. matëse	2021	2022	2023
Shpenzime operative	denarë	7.353.851	11.403.136	14.707.836
Amortizim	denarë	1.761.440	17.091.186	32.249.744
Mjete për likuiditet	denarë	54.621	151.043	242.821
Mjete të blera rishtas dhe të lëshuara në përdorim gjatë vitit	denarë	491.186.459	491.297.106	256.377
Kontribute të mjeteve të rregulluara	denarë	1.808.920	1.714.367	1.606.580
Të ardhura të tjera të realizuara gjatë realizimit të rolit të ujit	denarë			
TË ARDHURA TË RREGULLUARA (MAR)	denarë	10.978.832	30.359.731	48.806.981
Sasia	m³	1.300.502	1.302.345	1.304.227
Tarifa mesatare	den/m ³	7,75	16,90	25,32
Tarifa mesatare minimale	den/m ³	7,05	10,49	13,21
Tarifa mesatare maksimale	den/m ³	8,44	23,31	37,42

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit në datë 7 korrik 2020 ka publikuar Kërkesën në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit dhe në gazetën ditore “Sllloboden Peçat” dhe “Koha”.

Pas publikimit të Kërkesës, në afatin e përcaktuar në Lajmërimin deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit nuk janë lëvruar vërejtje, mendime dhe propozime nga personat e interesuar fizikë dhe juridikë.

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit në datë 10 korrik 2020 në faqen e tij të internetit ka publikuar Propozim-Aktvendimin të Përcaktimit të Tarifës për Grumbullim dhe për Deponim të Ujërave të Zeza Urbane të NP “Komunalec” Kërçovë, për periudhën e rregulluar 2021-2023

dhe u ka bërë thirrje të gjitha palëve të interesuara të lëvrojnë sugjerimet, vërejtjet dhe propozimet e tyre..

Pas publikimit të Propozim- Aktvendimit, në afatin e përcaktuar në Lajmërim deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit nuk janë lëvruar vërejtje, mendime dhe propozime nga personat e interesuar fizikë dhe juridikë.

Në pajtueshmëri me nenin 5, paragrafi (4) të Rregullores së Punës së Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit nr. 01-898 datë 30 mars 2020, nëse për vendimmarrje për çështjet sipas paragrafit (3) pikat 4), 5) dhe 6) të nenit 5, Komisioni Rregullator i Energjetikës përcakton se nuk ka nevojë për mbajtje të një seance përgatitore, do të miratojë Aktvendim për aktin për të cilin vendoset të miratohet në një seancë pa mbajtjen e seancës përgatitore.

Duke pasur parasysh se pas ndërprerjes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut ende ekziston pandemi nga sëmundje ngjithëse dhe në interes të ruajtjes së shëndetit të palëve, Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit me Aktvendim nr. 02-1612/1 datë 23 korrik 2020, ka vendosur të mbajë seancë për miratimin e këtij Aktvendimi, pa mbajtur seancë përgatitore

Analiza nga Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit

Gjatë analizës së të dhënave të lëvruara në Kërkesën e Vërtetimit të Tarifës për Grumbullim dhe për Deponim të Ujërave të Zeza Urbane për periudhën e rregulluar 2021-2023, Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit ka përcaktuar:

Përshkrimi	Nj. matëse	2021	2022	2023
Shpenzime operative	denarë	6.468.963	6.835.288	7.144.052
Amortizim	denarë	1.761.440	17.091.186	32.249.744
Mjete për likuiditet	denarë	50.216	128.223	205.019
Mjete të blera rishtas dhe të lëshuara në përdorim gjatë vitit	denarë	491.186.459	491.297.106	256.377
Kontribute të mjeteve të rregulluara	denarë	1.812.826	1.718.068	1.610.049
Të ardhura të tjera të realizuara gjatë realizimit të rolit të ujit	denarë	0	0	0
TË ARDHURA TË RREGULLUARA (MAR)	denarë	10.093.445	25.772.765	41.208.864
Sasia	m ³	1.300.502	1.302.345	1.304.227
Tarifa mesatare	den/m ³	7,07	13,39	19,51
Tarifa mesatare minimale	den/m ³	6,38	6,99	7,42
Tarifa mesatare maksimale	den/m ³	7,76	19,79	31,60

Pas analizës së kryer të shpenzimeve të realizuara operative nga periudha e parë e rregulluar dhe të dhënat nga plani afarist, Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit për periudhën e rregulluar 2021-2023, ka përcaktuar shpenzimet operative në pajtueshmëri me shumat e prezantuara në Kërkesë, si vijon:

1. Shpenzimet për materiale, energji, pjesë rezervë dhe inventar të imët për vitin themelor 2019 janë përcaktuar në pajtueshmëri me pjesëmarrjen procentuale të të ardhurave të realizuara nga shërbimi i ujit grumbullim dhe deponim i ujërave të zeza urbane në shumën totale të të ardhurave të realizuara të ndërmarrjes në vitin 2019. Shpenzimet e përcaktuara në këtë

- mënyrë, për secilin vit nga periudha e rregulluar rriten për normë inflacioni prej 1,5% (në pajtueshmëri me proekcionet e BPRM) dhe për vitin 2021 janë përcaktuar të jenë 1.277.550 denarë për vitin 2021, 1.296.713 denarë për vitin 2022 dhe 1.316.164 denarë për vitin 2023;
2. Shpenzimet për mirëmbajtje aktuale, riparim dhe shërbime për mirëmbajtje të mjeteve elementare, janë pranuar në pajtueshmëri me Kërkesën dhe të njëjtat kanë shumë prej 199.028 denarë për vitin 2021, 262.745 denarë për vitin 2022 dhe 311.492 denarë për vitin 2023;
 3. Shpenzimet për sigurim të mjeteve elementare janë pranuar në pajtueshmëri me Kërkesën dhe të njëjtat kanë shumë prej 15.897 denarë për vitin 2021, 44.883 denarë për vitin 2022 dhe 67.608 denarë për vitin 2023;
 4. Shpenzimet për bruto rrogat për vitin themelor 2019 janë përcaktuar në pajtueshmëri me pjesëmarrjen procentuale të numrit të punësuarve, të cilët punojnë për shërbimin e ujit grumbullim dhe deponim të ujërave të zeza urbane në numrin total të punësuarve në ndërmarrje në vitin 2019. Shpenzimet e përcaktuara në këtë mënyrë, për secilin vit nga periudha e rregulluar rriten për normë inflacioni prej 1,5% dhe për vitin 2021 janë përcaktuar të jenë 4.752.421 denarë, 4.823.707 denarë për vitin 2022 dhe 4.896.063 denarë për vitin 2023;
 5. Shërbimet e tjera janë pranuar në pajtueshmëri me Kërkesën dhe të njëjtat kanë shumë prej 89.609 denarë për vitin 2021, 207.734 denarë për vitin 2022 dhe 300.434 denarë për vitin 2023;
 6. Shpenzimet e tjera dhe ato të jashtëzakonshme për këto tre vite nga periudha e rregulluar janë përcaktuar në nivel të atyre që janë të përcaktuara për vitin 2020 nga ana e Komisionit rregullator të energjetikës dhe shërbimeve të ujit dhe të njëjtat janë 98.234 denarë.
 7. Tatimet, kontributet dhe detyrimet e tjera që nuk varen nga rezultati janë pranuar në pajtueshmëri me Kërkesën dhe të njëjtat kanë shumë prej 36.224 denarë për vitin 2021, 102.272 denarë për vitin 2022 dhe 154.056 denarë për vitin 2023;

Amortizimi i mjeteve personale elementare, me të cilat kryhet shërbimi i ujit është pranuar në pajtueshmëri me të dhënat nga Kërkesa dhe e njëjta ka shumë prej 1.758.550 denarë për vitin 2021, 2.201.156 denarë për vitin 2022 dhe 2.474.137 denarë për vitin 2023.

Amortizimi i mjeteve elementare të fituara falas, me të cilat kryhet shërbimi i ujit është pranuar në pajtueshmëri me të dhënat nga Kërkesa dhe e njëjta ka shumë prej 2.890 denarë për vitin 2021, 14.890.030 denarë për vitin 2022 dhe 29.775.607 denarë për vitin 2023.

Mjetet për likuiditet janë përlogaritur në nivel nga 0,50% nga të ardhurat e rregulluara në mënyrë të përcaktuar në pajtueshmëri me Metodologjinë dhe të njëjtat kanë shumë prej 50.216 denarë për vitin 2021, 128.223 denarë për vitin 2022 dhe 205.019 denarë për vitin 2023.

Kontributi i mjeteve elementare të rregulluara për shërbimin e ujit grumbullim dhe deponim të ujërave të zeza urbane për vitin 2021 ka shumë prej 1.812.826 denarë, për vitin 2022 ka shumë prej 1.718.068 denarë dhe për vitin 2023 ka shumë prej 1.610.049 denarë. Gjatë përlogaritjes së kontributit janë marrë parasysh investimet e planifikuara në shumë prej 491.186.459 denarë për vitin 2021, 491.297.106 denarë për vitin 2022 dhe 256.377 denarë për vitin 2023.

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit ka përcaktuar që tarifa mesatare për shërbimin e ujit grumbullim dhe deponim të ujërave të zeza urbane të jetë 7,07 den/m³ për vitin 2021, 13,39 den/m³ për vitin 2022 dhe 419,51 den/m³ për vitin 2023.

Gjatë përcaktimit të tarifës mesatare për shërbimin e ujit grumbullim dhe deponim të ujërave të zeza urbane, Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit ka pasur parasysh që çmimi i shërbimit të ujit të mos tejkalojë pragun e qasjes, të caktuar në nivel prej 3% nga mesatarja e të ardhurave totale për amvisëri në rajonin ku sigurohet shërbimi i ujit. Çmimi i shërbimit të ujit përfshin edhe tarifën për shërbimin e ujit, kontributet në lidhje me përdorimin e ujit dhe tatimet e përcaktuara me ligj. Gjithashtu në procesin e marrjes së Vendimit të Vërtetimit të Tarifës për Shërbimin e Ujit Grumbullim dhe Deponim të Ujërave të Zeza Urbane, NP "Komunalec" Kërçovë duhet t'i ketë parasysh efektet e ndërrimit të tarifës aktuale për grumbullim dhe deponim të ujërave të zeza urbane në çmimin përfundimtar të shërbimit të ujit, e cila faturohet deri te konsumatorët përfundimtar në rajonin e komunës së Kërçovë.

Qarku i lejuar minimal dhe maksimal nga vlera e përcaktuar e tarifës mesatare, të cilin NP "KOMUNALEC" Kërçovë do ta zbatojë gjatë marrjes së Vendimit të Përcaktimit të Tarifës për Shërbimin e Ujit Grumbullim dhe Deponim të Ujërave të Zeza Urbane ka shumë prej 9,78% për vitin 2021, 47,81% për vitin 2022 dhe 61,96% për vitin 2023.

NP "KOMUNALEC" Kërçovë gjatë marrjes së Vendimit të Përcaktimit të Tarifës për Shërbimin e Ujit Grumbullim dhe Deponim të Ujërave të Zeza Urbane duhet të ketë parasysh se tarifa mesatare minimale e lejuar i mbulon shpenzimet operative të ofruesit të shërbimit të ujit, amortizimin e mjeteve personale elementare dhe shpenzimin e borxhit afatgjatë të ofruesit të shërbimit të ujit, ndërsa tarifa mesatare maksimale e lejuar i mbulon shpenzimet operative të ofruesit të shërbimit të ujit, amortizimin e mjeteve personale elementare dhe amortizimin e mjeteve personale elementare të fituara falas, mjetet për likuiditet si dhe kontributin e mjeteve elementare të rregulluara.

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit e obligon NP "Ujësjiellësi" Kumanovë të mbajë evidencë të veçantë kontabiliste për secilin shërbim të ujit veçmas dhe për secilën veprimtari që e kryen, e cila nuk konsiderohet si shërbim i ujit, gjatë kohëzgjatjes së periudhës së rregulluar.

Aktvendimi i Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit është përfundimtar në procedurë administrative.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit ka vendosur sikur në dispozitën e këtij aktvendimi..

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të ngritë padi para Gjykatës Administrativ në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit, në pajtueshmëri me nenin 13 paragrafi (15) të Ligjit të Përcaktimit të Çmimeve të Shërbimeve të Ujit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/16).

PA1 nr. 08-119/20
23 korrik 2020
Shkup

Kryetar i Komisionit Rregullator të Energjetikës
dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së
Maqedonisë së Veriut

Marko Bislimoski

